



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 262 Prot.

Tiranë, më datë 27.04.2023

VENDIM
Nr. 260, datë 27.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 27.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për “Banesë 3 kat (Restaurim, Konservim, Rijetëzim) me vendndodhje në Rrugën “Kol Idromeno”, brenda kufirit Qendër Historike Shkodër, me aplikues Zef Çuni dhe zhvillues Aurel Gjerkaaj dhe plotësimin e aplikimit me pikat e mëposhtme:
 - Të paraqiten grafikisht patologjitë e gjendjes ekzistuese dhe të plotësohet grafikisht projekti;
 - Të shtohet grafikisht paraqitja e shtesës që do ndërtohet;
 - Të rishikohen zërat e preventivit në përputhje me manualët e çmimeve;
 - Të shtohet bashkëngjitur analiza përkatëse për secilin zë punimi (AN) në preventiv.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klësta QIRICI

